



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
KRYETARI

Nr. 358 Prot.

Tiranë, më 10.05.2018

Lënda: Për miratimin e ndryshimit të klasifikimit të pagës për emërtesën specialist në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE  
DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Tiranë

I nderuar Z. Manja,

Me Vendimin Nr. 92, datë 29.09.2017, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Në këtë strukturë, 3 specialistë të sekretarisë gjyqësore janë klasifikuar në nivelin e pagës IV-a dhe tre specialistë të profileve të ndryshme janë klasifikuar në nivelin IV-b.

Në zbatim të nenit C/14 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1 të Ligjit Nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë," ju përcjellim kërkesën tonë për miratimin e ndryshimit të nivelit të pagës së specialistit nga IV-a dhe IV-b në nivelin III- b.

Në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës përcaktohet se: "Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje. Bazuar në këtë përcaktim, kërkesa për riklasifikim të pagës së specialistit është në analogji me trajtimin e pagës së punonjësit specialist të Gjykatës Kushtetuese.

Efektet financiar të këtij ndryshimi është 1,6 milionë lekë (përfshirë 1,3 milionë lekë paga dhe 0,3 milionë lekë sigurime shoqërore). Ky efekt mund të përballohet me fondin e lirë të krijuar për shkak të mosplotësimit që në fillim të vitit, të strukturës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit.


Bashkëlidhur lutem gjeni propozimin për ndryshim në nivelin e pagës së specialistit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.



**KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT  
PËR KATEGORINË SPECIALIST ME NDRYSHIME**

Funksioni organik	Numri	Klasifikimi i Pagës	
		Ishte	Bëhet
<b>DREJTORIJA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>			
Specialist sekretarie gjyqësore	3	IV-a	III-b
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	1	IV-b	III-b
Specialist pritje me popullin	1	IV-b	III-b
<b>DREJTORIJA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.</b>			
Specialist protokoll/arkiv	1	IV-b	III-b



# PROSEDUR PELAKSANAAN KEMERDIAAN PASIEN



1. Tujuan dan Maksud

## 1.1. Tujuan

1.1.1. Untuk melindungi hak-hak pasien

## 1.2. Maksud

## 2. Ruang Lingkup

2.1. Ruang lingkup prosedur ini adalah meliputi seluruh pelayanan kesehatan yang diberikan kepada pasien di rumah sakit.

2.2. Ruang lingkup prosedur ini meliputi seluruh pelayanan kesehatan yang diberikan kepada pasien di rumah sakit.

2.3. Ruang lingkup prosedur ini meliputi seluruh pelayanan kesehatan yang diberikan kepada pasien di rumah sakit.

2.4. Ruang lingkup prosedur ini meliputi seluruh pelayanan kesehatan yang diberikan kepada pasien di rumah sakit.

2.5. Ruang lingkup prosedur ini meliputi seluruh pelayanan kesehatan yang diberikan kepada pasien di rumah sakit.

- Me shkresën tonë nr. 358, datë 10.05.2018, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, kemi përcjellë kërkesën për *miratimin e ndryshimit të nivelit të pagës, në analogji me pagën për specialistët e Gjykatës Kushtetuese për 3(tre) specialistë të sekretarisë gjyqësore nga niveli IV-a në nivelin III-b dhe 3 (tre) specialistë të profileve të ndryshme nga niveli IV-b në nivelin III-b*.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit C/14 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 18, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ju përcjellim kërkesën tonë për:

- 1- shtesë në VKM-në nr.187, datë 8.03.2017, me qëllim që Kolegji i Posaçëm i Apelit të përfshihet në fushën e veprimit të tij;
- 2- shtesë në vendimin nr. 92, datë 29.09.2017 të Kuvendit të Shqipërisë, me të cilin është miratuar struktura organizative, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për ndryshimin e nivelit të pagës së specialistit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

